

FLETËNOTIM

Kuvendi i Republikës së Kosovës

I – VI/2013

PERSONELI

Ismet KRYEZIU – Drejtor Ekzekutiv
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Valmir ISMAILI - Koordinator i programeve
email: vismaili@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës
dhe financave
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ – Asistente për administratë
dhe financa
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Arsim GJINOVCİ - IT & Design
email: agjinovci@kdi-kosova.org

PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE PRAKTIKAT PARLAMENTARE

Driton SELMANAJ - Menaxher i projektit
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Hulumtues
email: bramadanaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menaxhere e projektit
email: mmustafa@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Hulumtues kryesor
email: izejna@kdi-kosova.org

Besian BICURRI – Hulumtues
email: bbicurri@kdi-kosova.org

PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Naim CAHANAJ - Menaxher i projektit
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

Jetmir BAKIJA – Menaxher i Projektit
email: jbakija@kdi-kosova.org

Arben HOXHA - monitorues
email: ahoxha@kdi-kosova.org

PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA

Dardan BERISHA – Koordinator
email: dberisha@kdi-kosova.org

Shqipe GJOCAJ – Menaxhere e projektit
email: shgjocaj@kdi-kosova.org

Përmbajtja

▪ Mbarëvajtja e punimeve në seancat plenare.....	4
▪ Mbikëqyrja Parlamentare.....	5
▪ Komisionet parlamentare.....	6
▪ Dëgjimet Publike.....	8
▪ Monitorimi i zbatimit të ligjeve	9
▪ Plani legjislativ 2013	9
▪ Analiza Krahasuese e Deputetëve	11
▪ Tabela Gjenerale.....	12

▪ Mbarëvajtja e punimeve në seancat plenare

Ky Fletënotim përfshin të dhëna kuantitative dhe kualitative për punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për sesionin pranveror janar-qershor 2013. Punimet e sesionit pranveror për vitin kalendarik 2013, Kuvendi i filloi me seancën plenare të 21 janarit 2013.

Kjo periudhë raportuese ka rezultuar me një dinamikë të punës së institucionit më të lartë përfaqësues në vend me gjithsej 36 seanca plenare, prej tyre 22 ishin të rregullta, 2 të jashtëzakonshme kurse 11 ishin të karakterit solemn ku 8 prej tyre ishin më tepër të karakterit përkujtimor.

Edhe më tutje tema e cila po e mban nën dirigjim punën e Kuvendit të Kosovës, është çështja e dialogut mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Trajtimi i kësaj çështje është bërë në 5 seanca plenare, ku është zhvilluar një debat i nxehtë parlamentar. Kjo temë ka bërë që institucioni më i lartë përfaqësues energjinë më të madhe të tij ta orientoj në këtë drejtim, duke i lënë nën hije pothuajse të gjitha funksionet dhe mandatin kushtetues që ka.

Kjo temë jo vetëm që ngjalli debat të nxehtë në Kuvendin e Kosovës, por ajo u bë shkas edhe i protestave të organizuara nga Lëvizje Vetëvendosje me 28.06.2013, duke bllokuar deputetët që të futen në seancë plenare, dhe deri tek pengimi fizik nga deputetët e kësaj lëvizjeje për të mos lejuar rrjedhën e seancës plenare sipas agjendës së përcaktuar më parë.

Duhet konstatuar se Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon ta shkelë Rezolutën e Kuvendit për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, sidomos në mungesën e gatishmërisë së qeverisë për përfshirjen në proces të bisedimeve edhe trupave parlamentare (komisionet parlamentare) të Kuvendit të Kosovës, të përcaktuar me nenin 4 të kësaj Rezolutive.

Gjithashtu përkundër që ishte krijuar një praktikë e mirë e raportimit të kryeministrit të Kosovës para Kuvendit, pas çdo takimi të realizuar në Bruksel, kjo praktikë tanimë ka filluar të injorohet dhe me gjasë ratifikimi i marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, ka krijuar komoditet që kryeministri t'i ikë obligimeve që i ka dhënë Kuvendi i Kosovës.

Çështje tjetër që e ka karakterizuar këtë periudhë raportuese është pamundësia e Kuvendit të Kosovës që ta miratoj rregulloren e re të punës së këtij institucioni. Përkundër që kjo legjislaturë ka hyrë në vitin e fundit të mandatit të tij kushtetues, dhe përkundër që Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës, për më shumë 2 vite ka punuar në draftimin e Rregullores së re të Kuvendit të Kosovës, ky dokument nuk po arrin që të miratohet në Kuvendin e Kosovës. Kjo si duket po ndodh për shkak se drafti aktual i Rregullores është duke u kundërshtuar nga disa anëtarë të kryesisë së Kuvendit nga frika e "de pushtetizimit" të tyre. Rregullorja e re e Kuvendit, ka paraparë që shumicën e kompetencave ta marr organi i ri i Kuvendit të Kosovës, Konferenca e Kryetarëve, e cila do të përbëhej nga shefat e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve parlamentare.

Praktikat e ligjbërjes duke ju shmangur rregullave të Rregullores së Punës së Kuvendit, ishte instaluar në Kuvend në rastin e miratimit të pakos së ligjeve që dilnin nga Pakoja

gjithëpërfshirëse e Presidentit Ahtisari. Megjithatë përderisa ishte menduar që kjo praktikë aty ku filloi edhe do të mbaroj, nuk doli të jetë e saktë. Kjo tanimë është bërë një rutinë e keqe e punës së Kuvendit të Kosovës. Vitin e kaluar qeveria e Kosovës me pretekstin e përgatitjes së legjislacionit për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur, kishte proceduar për në Kuvendin e Kosovës Projektligjin për plotësim ndryshimin e 21 ligjeve të cilat janë në fuqi në Kosovë. Përkundër që kjo praktikë që me një projektligj të vetëm të amendamentohen 21 ligje tjera, ishte në kundërshtim me praktikën juridike të ligjbërjes, ajo u kalua me shumë lehtësi nga Kuvendi i Kosovës. Praktika e tillë vazhdoi edhe me rastin e miratimit të Ligjit për Amnistinë, ku brenda një dite u miratua në të dy leximet. Fatkeqësisht e njëjta gjë ndodhi edhe me 8 projektligjet që lidhen me procesin e liberalizimit të vizave mes Kosovës dhe BE-së. Kjo praktikë e keqe e ligjbërjes e instaluar në institucionet e vendit, në vazhdimësi po derivon legjislacion të dobët dhe vështirë të implementueshëm në praktikë.

Edhe më tutje pengesë për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit të Kosovës vazhdon të jetë, mungesa e madhe të deputetëve për të marrë pjesë në seanca plenare. Si rezultat i kësaj papërgjegjësie Kuvendi i Kosovës jo rrallë herë është detyruar që ti ndërpres punimet për mungesë kuorumi.

Një veçanti që e ka karakterizuar këtë sesion pranveror të Kuvendit të Kosovës, ka qenë instalimi i praktikës të seancave plenare me karakter komemorativ/ përkujtues. Vetëm gjatë këtij sesioni pranveror janë organizuar 8 seanca të karakterit të tillë. Gara e pakuptimtë politike mbi përvetësimin dëshmorëve dhe ngjarjeve historike, ka bërë që Kuvendi i Kosovës ta devijoj mandatin kushtetues që ka, duke e shndërruar veten në një institucion komemorativ në përkujtim të ngjarjeve dhe datave historike.

Ndikim në performancën negative të Kuvendit ka dhënë edhe mos efikasiteti i dy komisioneve të përkohshme parlamentare ai për reformë kushtetuese dhe reformë zgjedhore. Të dy këto komisione përkundër punës së tyre në draftimin e amendamenteve kushtetuese, projektligjit për Presidentin dhe adresimin e disa çështjeve për reformë zgjedhor, puna e tyre pa asnjë kuptim logjik dhe praktikë, ka mbetur peng i tekeve personale dhe politike të lidhshme politik në vend.

▪ Mbikëqyrja Parlamentare

Interpelancat & Pyetjet parlamentare

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktojnë Kosovën si një republikë demokratike e bazuar në parimin ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Për më tepër, mandati i kontrollit parlamentar të Kuvendit të Kosovës nuk kufizohet vetëm në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, por ai përfshinë edhe institucionet tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit të Kosovës.

Kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare ndaj ekzekutivit, ushtrohet përmes instrumenteve demokratike të mbikëqyrjes. Kjo më së shpeshti bëhet përmes pyetjeve parlamentare, interpelancave, nëpërmjet shqyrtimit të raporteve të qeverive mbi punën e tyre, duke

ngritur komisione të posaçme për të organizuar vizita në terren me qëllim kontrollit në praktikë të masave të caktuara të qeverisë, komisioneve hetimore, mocioneve të votëbesimit etj.

Në këtë periudhë raportuese janë zhvilluar 3 interpelanca parlamentare dhe 10 debate parlamentare. Tendanca në rritje e kërkesave për debat parlamentar nuk po dëshmohet si mekanizëm i suksesshëm në Kuvendin e Kosovës. Debatet e tilla më shumë po shfrytëzohen për promovim politik personal dhe grupor sesa thirrje për llogaridhënie dhe përgjegjësi.

Nga ana tjetër hezitimi i ministrave të kabinetit qeveritar për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare të deputetëve, prania e rrallë e tyre në seanca plenare kur trajtohen çështje që dalin nga fushë veprimtaria e tyre, mos përgjigja ndaj ftesave të komisioneve parlamentare për të raportuar në mbledhjet e tyre e deri tek injorimi i rekomandimeve apo qëndrimeve që dalin nga institucioni më i lartë përfaqësues në vend, janë raste të cilat dëshmojnë qartë për pa mundësi të ushtrimit të kompetencave kushtetuese të mbikëqyrjes së ekzekutivit nga ana e legjislativit.

Pyetjet parlamentare si instrument të kontrollit parlamentar, në Kuvendin e Kosovës nuk po arrijnë qëllimin dhe efektin e tyre. Numri jo edhe aq i madh i pyetjeve parlamentare të parashtruara nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, si dhe injorimi i tyre i vazhdueshëm nga kabineti qeveritar, duke i ofruar përgjigje krejtësisht periferike apo edhe duke mos qenë të pranishëm fare në seanca plenare, ka dëshmuar se ky lloj kontrolli nuk ka qenë shembulli i mirë i ushtrimit të kompetencave kushtetuese që kanë institucionet tona përfaqësuese.

Kontrolli i dobët parlamentar nga njëra anë dhe nga ana tjetër tendencat e fuqishme nga ekzekutivi i vendit për ta shndërruar Kuvendin e Kosovës në legjitimues me çdo kusht të vendimeve të saja, ka bërë që Kuvendi i Kosovës edhe pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, të mos arrijë të fuqizohet bazuar në kompetencat kushtetuese

Fatkeqësisht kjo dëshmon që edhe më tutje në jetën parlamentare, mungon një sistem i përhershëm dhe i qëndrueshëm i kontrollit parlamentar, i cili po vjen nga moskuptimi i kontrollit parlamentar si funksion kushtetues pa marrë parasysh pozicionimin politik në pozitë apo opozitë brenda Kuvendit të Kosovës.


▪ **Komisionet parlamentare**

Komisioni për Buxhet dhe Financa më aktivi

Komisionet parlamentare, si trupa shumë të rëndësishme të legjislativit, sikurse në të gjitha praktikat parlamentare, edhe në Kuvendin e Kosovës bëjnë punën më kruciale të nxjerrjes së ligjeve dhe dokumenteve të caktuara. Aspekti legjislativ, apo i shqyrtimit paraprak/përgatitjes së projektligjeve që vijnë nga sponsoruesit, si dhe kontrolli që i bëjnë ekzekutivit janë disa nga aktivitetet që i bëjnë komisionet të rëndësishme për nga funksionimi.

Nga numri total prej 212 takimeve (përfshirë edhe Nën-komisionin për Mandate dhe Imunitete) dhe 13 organizimeve të dëgjimeve publike, i bie që çdo komision ka mbajtur mesatarisht 15 takime për gjashtë muaj, apo 1-2 takime në muaj. Në këtë aspekt, ka pasur raste kur një Komisioni sikurse ai për Buxhet dhe Financa ka mbajtur 7 takime brenda muajit, por edhe kur një Komision tjetër sikurse ai për Mbikëqyrjen e AKI-së që kanë mbajtur vetëm një takim përgjatë një muaji.

Ndërkohë, krahasuar me gjashtëmujorin paraprak (korrik-dhjetor 2012) ku ishin mbajtur 190 mbledhje, ka pasur një rritje mesatare të aktiviteteve të Komisioneve në 212 mbledhje, apo 22 më shumë.



Komisioni parlamentar më aktiv – apo me më shumë mbledhje të mbajtura përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013 është ai për Buxhet dhe Financa, me gjithsej 26 mbledhje. Pas tij renditet Komisioni për Zhvillim Ekonomik me 23 takime dhe ai për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor me 19 takime.

Komisioni më pasiv – apo me më pak mbledhje të mbajtura ka qenë ai për Mbikëqyrjen e AKI-së, me gjithsej 9 takime përgjatë gjashtë muajve. Ndërkohë, Nën-komisioni për Mandate dhe Imunitete, ka mbajtur vetëm 7 takime. Ndër tre komisionet me më pak mbledhje të mbajtura është edhe ai për Mbikëqyrjen e Financave Publike me 11 takime.

Periudha më e ngarkuar me angazhime të Komisioneve ka qenë gjatë muajve shkurt, mars dhe prill. Vetëm gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithsej 116 mbledhje.

Sa i përket funksionimit, edhe përgjatë kësaj periudhe Komisionet Parlamentare vazhdojnë të ballafaqohen me sfida të ndryshme. Gjatë monitorimit që KDI i ka bërë punës së Komisioneve është evidentuar se këto trupa, përkatësisht administrata vazhdojnë të ballafaqohen me mungesë të profesionistëve dhe ekspertëve të mjaftueshëm që do t'i

trajtonin ligjet dhe dokumentet që vijnë nëpër komisione, një ndihmesë kjo për anëtarët e komisioneve. Një element tjetër me të cilin sfidohet puna e komisioneve është edhe mungesa e fuqisë së tyre karshi kontrollit ndaj ekzekutivit. Shumë herë, mbledhjet e komisioneve dështojnë për shkak të refuzimit të ftesës nga ministra të ndryshëm për të raportuar për çështje të ndryshme që ngritën nga deputetët.

Ndërkohë, sa i përket komunikimit të jashtëm dhe transparencës, me gjithë gatishmërinë e treguar, komisionet vazhdojnë të kenë ngecje në komunikimin elektronik. Dokumentet e ndryshme, përfshirë projektligjet, raportet, strategjitë e ndryshme, etj, shpeshherë nuk janë të qasshme në mënyrë elektronike dhe mungojnë në ueb faqen elektronike të Kuvendit.

▪ Dëgjimet Publike

Injorimi i qytetarëve dhe palëve të interesit në ligjbërje

Megjithëse vlerësohet si një prej formave më të mira të gjithpërfshirjes dhe marrjes së mendimit të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit, dëgjimet publike po e reflektojnë anën negative të komisioneve. Shumica e ligjeve kalojnë nga komisionet pa organizim të dëgjimeve publike, edhe pse një gjë e tillë është në mandatin e komisioneve. Kjo formë e injorimit që komisionet po i bëjnë përfshirjes së qytetarëve, palëve të interesit dhe institucioneve të interesuara gjatë proceseve të shqyrtimit dhe analizimit të projektligjeve, me të drejtë shpeshherë ka nxitur reagimin e shoqërisë civile.

Për dallim nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2012 kur kishte vetëm 12 dëgjime publike, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 ka pasur vetëm një më shumë, përkatësisht 13 dëgjime publike. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe komisionet kanë shqyrtuar afër 30 projektligje.

Nëse krahasohet numri prej 29 projektligjeve të shqyrtuara brenda gjashtë muajve, ndërkohë janë organizuar vetëm 13 dëgjime publike, del se komisionet kanë konsultuar publikun vetëm për më pak se gjysmën e projektligjeve të shqyrtuar. Një praktikë e tillë tregon se ligjbërja nga Kuvendi kalon pa përfshirje të shoqërisë civile në shumicën e rasteve.

Megjithatë, komisionet që kanë organizuar këto 13 dëgjime publike janë vetëm gjashtë nga 13 sosh. Nga ky numër, Komisioni për të drejtat, interesat e Komuniteteve dhe për Kthim ka organizuar 4 dëgjime publike, aq sa ka organizuar edhe Komisioni për Zhvillim ekonomik. Dy dëgjime publike ka organizuar Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe nga një kanë organizuar Komisioni për punë të brendshme, ai për të të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe Nën-komisioni për mandate dhe imunitete.

Për më tepër, në raste të caktuara kur janë organizuar dëgjime publike, nuk ka pasur gatishmëri nga ana e komisioneve për t'i marrë parasysh rekomandimet apo vërejtjet e pjesëmarrësve. Në këtë drejtim, Komisionet parlamentare, përveç se duhet rritur numrin e dëgjimeve publike, duhet rritur edhe gatishmërinë për të qenë më efikas, duke i marrë parasysh opinionet e palëve të interesuara.

▪ **Monitorimi i zbatimit të ligjeve**

Një problem tjetër që ka përshkuar punën e Komisioneve parlamentare gjatë këtij gjashtëmujori ka qenë edhe mungesa e shfrytëzimit të mandatit dhe përgjegjësive për të monitoruar zbatimin e ligjeve. Përkundër planifikimeve që kanë bërë në planet e punës, shumica e këtyre trupave nuk kanë arritur të përfundojnë monitorimin e ligjeve të parapara. Ka edhe Komisione sikurse ai për Bujqësi që megjithëse ka planifikuar monitorimin e tre ligjeve, nuk ka arritur as të fillojë procesin, kjo për shkak siç thuhet mungesës së mjeteve financiare që duhet mbuluar për monitorimin e disa ligjeve specifike siç është ai për Mbrojtjen nga Zhurma apo Mbrojtjen e Ajrit.

Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, Komisioni për Zhvillim ekonomik ka përfunduar monitorimin e Ligjit për masat mbrojtëse ne importe, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka monitoruara Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Në proces të monitorimit komisionet tjera kanë nga një, dy dhe më shumë ligje. Me më së shumti monitorim të ligjeve në proces është Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, me gjithsej tre ligje në proces, por që ende nuk kanë përfunduar asnjërin nga ta. Po ashtu edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe ai për Punë të Brendshme janë në proces të monitorimit të nga dy ligjeve. Ndërsa komisionet tjera janë kryesisht në proces të monitorimit të nga një ligji.


Ky fenomen negativ që po e përcjell punën e Kuvendit kërkohet medoemos që të tejkalohet, në mënyrë që përveç implementimit të mandatit të tyre, do të duhej edhe të dëshmonin gatishmërinë për të parë zbatimin në terren të ligjeve. Ky aktivitet do të ndihmonte Kuvendin që në rastet e mungesës apo problemeve në zbatim të ligjeve, të merren masa, apo edhe iniciativa për ndryshime dhe plotësime.

▪ **Plani legjislativ 2013**

Gjysma e vitit, as gjysma e punës!

Me gjithë ambiciet e mëdha, me dinamikën aktuale, Kuvendi i Kosovës nuk është në rrugë të përmbushjes së programit legjislativ për vitin 2013. Sipas këtij programi, të miratuar më 26 dhjetor të vitit 2012, janë paraparë që të miratohen 98 ligje. Ndërkohë, megjithëse programi i Kuvendit edhe më tej varet nga strategjia legjislative e Qeverisë, në gjashtëmujorin e parë Kuvendi i Kosovës ka arritur që në lexim të parë të kalojë 29 projektligje, po aq sa ka shqyrtuar edhe në lexim të dytë.

Krahasuar me vitin e kaluar kur për 12 muaj ishin miratuar 62 projektligje, në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë miratuar rreth gjysma e këtij numri, 29. Ky krahasim tregon se nëse legjislativi vazhdon me këtë dinamikë, por edhe dinamikën e vitit të kaluar, programi legjislativ do të zbatohet rreth 70 për qind. Po ashtu, kjo statistikë tregon se në gjashtëmujorin e dytë, Kuvendin e Kosovës e pret një punë shumëfish më dinamike.



Ndërkohë, një problem tjetër sa i përket programit të punës së Kuvendit është edhe ajo se nga 98 projektligje të parapara për miratim gjatë vitit 2013, më shumë se gjysma e tyre janë për ndryshim-plotësim. Mbi 60 për qind, apo 63 projektligje të sponsoruara nga Qeveria janë për plotësim ndryshim. Një fenomen i tillë tregon për kualitetin jo të mirë të ligjeve që po draftohen dhe miratohen nga institucionet tona qendrore. Prandaj kjo nxjerrë konkluzionin për nevojën e shtimit të konsultimeve publike gjatë të gjitha fazave të draftimit të ligjeve, qoftë brenda qeverisë po ashtu edhe brenda Kuvendit të Kosovës.

▪ Analiza Krahasuese e Deputetëve

Deputetët më aktiv

1. Visar Ymeri	3.97 %
2. Halit Krasniqi	3.92 %
3. Alma Lama	3.10 %
4. Myzejene Selmani	2.86 %
5. Albulena Haxhiu	2.51 %
6. Ardian Gjini	2.30 %
7. Teuta Haxhiu	2.26 %
8. Time Kadriaj	2.26 %
9. Arben Gashi	2.13 %
10. Muhamet Mustafa	2.00%
11. Teuta Sahatqija	2.00 %

Deputetët më pasiv

1. Rada Trajkovic	- 0.33 %
2. Florin Krasniqi	- 0.26 %
3. Sreten Ivanovic	- 0.24 %
4. Skender Hyseni	- 0.22 %
5. Sasha Gjokic	- 0.20 %
6. Vesimir Savic	- 0.15 %
7. Ukë Rugova	- 0.15 %
8. Vesna Mikic	- 0.11 %
9. Bali Muharremaj	- 0.11 %
10. Azem Syla	- 0.09 %

▪ Tabela Gjenerale

Kuvendi i Kosovës			Pjesëmarrje në diskutime	Diskutim në emër të gr. apo Komisionit	Çështje apo propozime	Çështje urgjente	Propozim amendamente	Nisma Ligjore	Kërkesa për Interpellancë	Pyetje parlamentare	Mungesa në seanca	Kërkesa për debate parlamentar	Notimi i përgjithshëm	Notimi në %		
Deputetë	Subjekti	Deputetët	4 pikë	2 pikë	5 pikë	9 pikë	3 pikë	10 pikë	8 pikë	5 pikë	1 - pikë	7 pikë				
1	34	PDK	ADEM GRABOVCI	8	14	0	0	0	0	0	-4	0	18	0.33%		
2			ARSIM BAJRAMI	32	18	0	0	0	0	0	15	-6	0	59	1.10%	
3			AZEM SYLA	0	0	0	0	0	0	0	0	-5	0	-5	-0.09%	
4			BEHAR SELIMI	12	12	0	0	0	0	0	0	-4	0	20	0.37%	
5			BEKIM HAXHIU	80	0	20	0	3	0	0	0	20	-5	7	125	2.32%
6			BERAT BUZHALA	16	0	5	0	0	0	0	0	5	-10	0	16	0.30%
7			BLERTA DELIU-KODRA	36	8	30	0	0	0	0	0	0	-3	0	71	1.32%
8			ELMI REÇICA	4	12	0	0	0	0	0	0	0	-3	0	13	0.24%
9			FADIL DEMAKU	32	2	5	0	0	0	0	0	0	-1	0	38	0.71%
10			FATMIR LIMAJ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-35	0	-35	-0.65%
11			FATMIR XHELILI	8	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12	0.22%
12			FLORA BROVINA	4	4	5	0	0	0	0	0	0	-5	0	8	0.15%
13			GANIMETE MUSLIU	44	2	15	0	0	0	0	0	25	-3	0	83	1.54%
14			HALIT KRASNIQI	128	8	20	0	0	0	0	0	55	0	0	211	3.92%
15			HASIME KRASNIQI	4	20	0	0	0	0	0	0	0	-4	0	20	0.37%
16			HYDAJET HYSENI	56	0	5	0	0	0	0	0	0	-6	0	55	1.02%
17			IDRIZ VEHAJI	8	32	0	0	0	0	0	0	0	-3	0	37	0.69%
18			JAKUP KRASNIQI	36	0	15	0	0	0	0	0	0	0	0	51	0.95%
19			JUSTINA PULA	16	2	5	0	0	0	0	0	10	-9	0	24	0.45%
20			KURTAN KAJTAZI	12	4	0	0	0	0	0	0	0	-1	0	15	0.28%
21			LATIF GASHI	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-4	0	-4	-0.07%
22			LUMNIJE MORINA	16	0	0	0	0	0	0	0	0	-3	0	13	0.24%
23			NAHIT HASANI	20	14	20	0	0	0	0	0	0	-3	0	51	0.95%
24			NIJAZI IDRIZI	24	12	15	0	0	0	0	0	0	-2	0	49	0.91%
25			RAMË VATAJ	12	4	5	0	0	0	0	0	0	-8	0	13	0.24%
26			RAMIZ LLADROVCI	60	4	10	0	0	0	0	0	0	-2	0	72	1.34%
27			SAFETE HADERGJONAJ	12	54	0	0	0	0	0	0	0	-4	0	62	1.15%
28			SALA BERISHA – SHALA	28	22	10	0	0	0	0	0	0	-6	0	54	1.00%
29			SALIHE MUSTAFA	16	6	0	0	0	0	0	0	10	-1	0	31	0.58%
30			SHAIP MUJA	76	10	15	0	0	0	0	0	0	-5	0	96	1.78%
31			VALBONA DIBRA	32	0	15	0	0	0	0	0	0	-4	0	43	0.80%
32			XHAVIT HALITI	0	0	5	0	0	0	0	0	0	-4	0	1	0.02%

33		XHEVAHIRE IZMAKU	24	18	15	0	0	0	0	0	-2	0	55	1.02%	
34		ZENUN PAJAZITI	44	52	5	0	0	0	0	0	-2	0	99	1.84%	
35	27	LDK	AFERDITA BERISHA – SHAQIRI	28	6	10	0	0	0	10	-1	0	53	0.98%	
36			ALI SADRIU	24	4	5	0	0	0	0	0	0	0	33	0.61%
37			ANTON QUNI	8	6	0	0	0	0	0	0	0	0	14	0.26%
38			ARBEN GASHI	60	44	15	0	0	0	0	0	-4	0	115	2.13%
39			ARMEND ZEMAJ	60	18	0	0	0	0	0	0	-1	0	77	1.43%
40			BAHRI THAÇI	12	0	0	0	0	0	0	0	-3	0	9	0.17%
41			EQREM KRYEZIU	20	0	0	0	0	0	0	0	-2	0	18	0.33%
42			HAKI DEMOLLI	72	0	20	0	0	0	0	0	-1	0	91	1.69%
43			HASHIM DESHISHKU	76	8	10	0	0	0	0	10	-3	0	101	1.87%
44			HYKMETE BAJRAMI	56	12	25	0	0	0	0	10	-4	0	99	1.84%
45			IMRI AHMETI	12	2	5	0	0	0	0	0	0	0	19	0.35%
46			ISMET BEQIRI	18	50	15	0	0	0	0	0	-3	0	80	1.49%
47			LIRIJE KAJTAZI	20	8	5	0	0	0	0	15	-6	0	42	0.78%
48			LUTFI HAZIRI	52	4	10	0	0	0	0	0	-9	7	64	1.19%
49			LUTFI ZHARKU	4	10	0	0	0	0	0	0	-3	0	11	0.20%
50			NASER OSMANI	8	8	0	0	0	0	0	0	-7	0	9	0.17%
51			NAZANE BRECA	20	6	5	0	0	0	0	5	-5	0	31	0.58%
52			KIMETE BYTYCI	4	0	5	0	0	0	0	35	-1	0	43	0.80%
53			RITA HAJZERAJ – BEQAJ	16	6	5	0	0	0	0	5	-1	0	31	0.58%
54			SABRI HAMITI	88	6	5	0	0	0	0	0	-5	0	94	1.74%
55			SADRI FERATI	80	10	15	0	0	0	0	0	-2	0	103	1.91%
56			SALI ASLLANAJ	8	2	0	0	0	0	0	0	-3	0	7	0.13%
57			SALIH MORINA	60	16	25	0	0	0	0	0	-3	0	98	1.82%
58			SKENDER HYSENI	0	0	0	0	0	0	0	0	-12	0	-12	-0.22%
59			TEUTA SAHATQIJA	64	16	30	0	0	0	0	0	-2	0	108	2.00%
60			VJOLLCA KRASNIQI	16	6	5	0	0	0	0	10	-1	0	36	0.67%
61			VJOSA OSMANI	40	12	20	0	0	0	0	15	-7	0	80	1.49%
62	12	LVV	AFRIM HOTI	16	4	15	0	0	0	10	-1	0	44	0.82%	
63			ALBANA FETOSHI	0	16	0	0	0	0	15	-2	0	29	0.54%	
64			ALBANA GASHI	24	8	15	0	0	0	25	-2	0	70	1.30%	
65			ALBIN KURTI	72	4	10	0	0	0	10	-6	0	90	1.67%	
66			ALBULENA HAXHIU	60	20	10	0	0	0	45	0	0	135	2.51%	
67			ALMA LAMA	76	2	35	0	0	10	50	-6	0	167	3.10%	
68			AFRIM KASOLLI	24	22	5	0	0	0	10	-4	0	57	1.06%	
69			FLORIN KRASNIQI	0	2	5	0	0	0	0	-21	0	-14	-0.26%	
70			GLAUK KONJUFCA	52	12	25	0	0	0	5	-3	0	91	1.69%	
71			LIBURN ALIU	36	36	20	0	0	0	20	-6	0	106	1.97%	
72			REXHEP SELIMI	28	8	20	0	0	0	5	-4	0	57	1.06%	
73			VISAR YMERI	62	76	45	0	0	0	35	-4	0	214	3.97%	
74	12	AAK	AHMET ISUFI	16	12	5	0	0	0	0	-3	0	30	0.56%	

75		ARDIAN GJINI	34	62	20	0	12	0	0	0	-4	0	124	2.30%		
76		BALI MUHAREMAJ	0	0	0	0	0	0	0	0	-6	0	-6	-0.11%		
77		BLERIM SHALA	0	4	0	0	0	0	0	0	-6	0	-2	-0.04%		
78		BURIM RAMADANI	28	24	20	0	0	0	8	20	0	0	100	1.86%		
79		DAUT HARADINAJ	4	8	5	0	0	0	0	0	-5	0	12	0.22%		
80		DONIKA KADAJ – BUJUPI	32	8	25	0	0	0	0	5	-6	0	64	1.19%		
81		KYMETE BAJRAKTARI	20	4	20	0	0	0	0	0	-1	0	43	0.80%		
82		RAMIZ KELMENDI	0	2	0	0	0	0	0	0	-15	14	1	0.02%		
83		TEUTA HAXHIU	60	14	25	0	0	0	0	25	-2	0	122	2.26%		
84		XHEVDET NEZIRAJ	24	30	10	0	0	0	0	0	-2	0	62	1.15%		
85		TIME KADRIJAJ	40	32	15	0	0	0	8	30	-3	0	122	2.26%		
86	11	SLS	MILIVOJE STOJANOVIC	0	14	0	0	0	0	0	5	-3	0	16	0.30%	
87			JELENA BONTIC	0	6	0	0	0	0	0	0	0	-1	0	5	0.09%
88			PETAR MILETIC	0	22	0	0	0	0	0	0	0	-5	0	17	0.32%
89			JASMINA ZIVKOVIC	4	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14	0.26%
90			SASA MILOSAVLJEVIC	0	20	5	0	0	0	0	0	0	0	0	25	0.46%
91			BISERKA KOSTIC	0	6	5	0	0	0	0	0	0	-1	0	10	0.19%
92			ETEM ATIFI	0	2	0	0	0	0	0	0	0	-2	0	0	0.00%
93			SASA ĐOKIC	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-11	0	-11	-0.20%
94			GORAN MARINKOVIC	16	18	20	0	0	0	0	0	10	0	0	64	1.19%
95			BOBAN TODOROVIC	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-1	0	-1	-0.02%
96	MURSELJ HALJILJI	4	0	5	0	0	0	0	0	10	-2	0	17	0.32%		
97	6	KKR	GEZIM KELMENDI	32	14	15	0	0	0	0	0	-2	0	59	1.10%	
98			JETON SVIRCA	12	16	5	0	0	0	0	0	0	-2	0	31	0.58%
99			MYZEJENE SELMANI	18	126	10	0	0	0	0	0	0	0	0	154	2.86%
100			SEVDIJE LAMA	0	32	0	0	0	0	0	0	0	-3	0	29	0.54%
101			SUZAN NOVOBRDALIU	8	8	0	0	0	0	0	0	0	-2	0	14	0.26%
102			UKË RUGOVA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-8	0	-8	-0.15%
103	6	6+	RASIM DEMIRI	0	4	0	0	0	0	0	0	-3	0	1	0.02%	
104			ENIS KERVAN	0	8	0	0	0	0	0	0	5	-10	0	3	0.06%
105			DUDA BALJE	0	8	10	0	0	0	0	0	0	-4	0	14	0.26%
106			ALBERT KINOLLI	0	14	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14	0.26%
107			MUFERA SINIK	0	20	0	0	0	0	0	0	0	-7	0	13	0.24%
108			FIKRIM DAMKA	0	12	0	0	0	0	0	0	0	-8	0	4	0.07%
109	12	PA GRUP	AURORA BAKALLI	36	0	10	0	0	0	0	15	-2	0	59	1.10%	
110			AMIR AHMETI	16	0	0	0	0	0	0	0	0	-5	0	11	0.20%
111			AGIM KULETA	32	0	5	0	0	0	0	0	0	-1	0	36	0.67%
112			MUHAMET MUSTAFA	100	0	10	0	0	0	0	0	0	-2	0	108	2.00%
113			HAMZA BALJE	0	2	5	0	0	0	0	0	0	-3	0	4	0.07%
114			EMIN GERBESHI	20	0	0	0	0	0	0	0	0	-1	0	19	0.35%
115			VESIMIR SAVIC	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-8	0	-8	-0.15%
116			VESNA MIKIC	4	0	0	0	0	0	0	0	5	-15	0	-6	-0.11%
117			EMILJA REDZEPI	40	4	10	0	0	0	0	0	0	-3	0	51	0.95%
118			RADA TRAJKOVIC	4	0	0	0	0	0	0	0	0	-22	0	-18	-0.33%

119		SRETEN IVANOVIC	0	0	0	0	0	0	0	0	-13	0	-13	-0.24%
120		DANUSH ADEMI	8	2	0	0	0	0	0	10	-3	0	17	0.32%
			2888	1376	940	0	15	10	16	625	-	28	5387	100.00%

Nr. i deputeteve	Grupi parlamentar													
34	PDK	900	338	240	0	3	0	0	140	-157	0	1471	27.31%	
27	LDK	926	260	235	0	0	0	0	115	1536	35	1454	26.99%	
12	LVV	450	210	205	0	0	10	8	230	-59	7	1046	19.42%	
12	AAK	258	200	145	0	12	0	16	80	-53	0	672	12.47%	
11	SLS	24	98	35	0	0	0	0	25	-26	0	156	2.90%	
9	KKR	70	196	30	0	0	0	0	0	-17	0	279	5.51%	
6	6+	0	66	10	0	0	0	0	5	-32	0	49	2.54%	
9	Pa grup	260	8	40	0	0	0	0	30	-78	0	260	2.86%	
		2888	1376	940	0	15	10	24	625	1114		5387	100.00%	

